



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 467/2 prot.,

Datë 28.02.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra*”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “*Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme*”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*INTERLOGISTIC*” SHPK me NIPT: K21605003M dhe me adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës km 09, Kashar, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A
Adresa: L.17 Rruga “Dalip Peza”, Durrës.
- Persona të interesuar:** Operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” SHPK me NIPT: L91418502J dhe me adresë: *Zona Kadestrale nr.8517, e llojit trull plus ndërtesë 4 kate, me sipërfaqe trualli 1’000 m2 dhe sipërfaqe ndërtesë 330 m2, Spitallë, Durrës.*

Në datën 27.02.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/3835, datë 27.02.2024, dhe me nr. 467/2024 prot, datë 27.02.2024 e operatorit ekonomik “*INTERLOGISTIC*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra*”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “*Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme*”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “*INTERLOGISTIC*” SHPK, në ankesën me numër elektronik A/2024/3835, datë 27.02.2024, dhe me nr. 467/2024 prot, datë 27.02.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “*Librari Dyrrahu*” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

“I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim/deklaratë/autorizim nga prodhuesi ose te distributorit të autorizuar për /artikullin

- *(Nr:1) Leter A4 80g/m2,*

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar
Vertetimet/deklaratat/autorizimet duhet të përmbajnë të dhëna të plota si: telefoni/e-mail/website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.4.3 Operatoret ekonomike pjesëmarrës në këtë procedurë duhet që ditën dhe orën e hapjes së ofertave, të paraqesin mostra për artikujt me nr rendor: Rendor 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 16, 21, 22, 24, 26, 28, 51. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Gjithashtu ofertuesi “Librari Dyrrahu” SHPK nuk ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 28.02.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro